

VENDIM
Nr. 78, datë 31.1.2020

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSITË
ADMINISTRATIVE 4 DHE 8, ZONA “5 MAJI”, BASHKIA TIRANË, DHE
CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË DHE SHOQËRISË “TIRANA DC” SH.A., SI
NJËSI ZBATUESE**

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 9.2.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” dhe “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, të zonës “5 Maji”, njësitë administrative 4 dhe 8, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim, sipas hartës dhe koordinatave të aneksi nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese në pjesët e sipërfaqes, sipas hartës dhe koordinatave, dbënë në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

- a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
- b) ndërtimin e rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe kritike;
- c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
- ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

2.1 Caktimin e “Tirana DC” sh.a., si njësi zbatuese në pjesët e sipërfaqes, sipas hartës dhe koordinatave, dbënë në aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:


- a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
- b) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
- c) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KUFIRI I ZONËS PËR RINDËRTIM 5 MAJI | ANEKSI 1



KUFIRI I ZONËS PËR RINDËRTIM 5 MAJI | ANEKSI 2



An aerial photograph of a city area. A red dashed line outlines a specific region in the upper half of the image, which includes a river and some industrial or commercial buildings. A yellow dashed line outlines a larger region that encompasses the red-outlined area and extends downwards into a densely populated residential area. The yellow line follows a major road or boundary. The red line follows the river and some specific buildings. The overall image shows a mix of urban development, including residential housing, commercial buildings, and a river.

[illegible]

LEGIJENDA

 KUPETI I TËRRIORITETIT QË JENËN PËR
PËRSHIRJE: LËNJANË MËDË

 KUPETI I TËRRIORITETIT QË JENËN PËRSHIRJE
QË ËSHTË TËRRIORITETI I KUPËTIT

POZITSIONI NE TËRRIORIN E RASHKISË TIRANË



RASHKË

DUKË

PËRTORE